



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

31.10.2013

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Prishtinë - Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit mbajti sot mbledhjen e radhës, ku në agjendë kishte shumë çështje për diskutim ku u morën vendime me rëndësi për proceset që zhvillon Agjencia. Fillimisht u miratuan transaksionet e Valës 59, të cilat shitje janë zhvilluar nga Agjencia përmes një procesi të hapur dhe transparent. Gjithashtu anëtarët e Bordit diskutuan dhe u pajtuan njëzëri që të lirojnë nga administrimi i drejtpërdrejtë Ndërmarrjen Shoqërore Pallati i Rinisë në Prishtinë dhe tani e tutje kjo NSH do të administrohet nga zyra regjionale e Agjencisë.

Bordi i Drejtorëve në këtë takim gjithashtu diskutoi për zhvillimet e fundit lidhur me Ndërmarrjen Shoqërore “Trepça” e cila është nën administrimin e AKP-së.

Bordi gjithashtu miratoi listën përfundimtare për punëtorët e NSH “Yumco”, ku nga kjo listë gjithsej përfitojnë 219 punëtorë.

AKP-ja ka vazhduar me shitjen e banesave të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore sipas Ligjit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, dhe në mbledhjen e sotme Bordi aprovoi vendimet për shitjen e 40 banesave tek shfrytëzuesit e ligjshëm të tyre që i kanë plotësuar kushtet ligjore për blerje. Ky proces i shitjes së banesave në pronësi të NSH-ve është i rëndësishëm dhe i ndihmon procesit të likuidimit të atyre NSH-ve.

Në këtë takim Bordi diskutoi dhe morri vendim që të inicioj procedurën për futjen e 60 Ndërmarrjeve Shoqërore në Likuidim. Ky vendim paraqet një progres të madh përsa i përket përfshirjes së Ndërmarrjeve Shoqërore në procesin e likuidimit,

FUND

Rr. Ilir Konushevc i No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org